

CRNA GORA
MALI I ZI
SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
KUVENDI I KOMUNËA SË ULQINIT
Br./Nr. 02-65/2
Ulcinj/Ulqin: 30.10.2017

Në bazë të nenit 147 të Ligjit për mediat elektronike ("Fl. zyr. MZ", nr. 46/10), nenit 64 të Ligjit për shoqëritë ekonomike ("Fl. zyr. RMZ", nr. 6/02), nenit 32, paragrafi 1, pika 18 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. RMZ", nr. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06 dhe ("Fl. zyr. MZ", nr. 88/09 dhe 3/10) dhe nenit 42, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. RMZ – dispozitat e komunës", nr. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06 dhe ("Fl. zyr. RMZ – dispozitat e komunës", në 5/07 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, shpallën

THIRRJE PUBLIKE
(e treta me radhë)

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të RTUL

Anëtarët e Këshillit zgjedhen nga radhët e profesionistëve të afirmuar nga fushat që janë relevante për ushtrimin e veprimtarisë së RTUL gazetaria, drejtësia, ekonomia, shkencat teknike, sociologjia, marketingu, radio difuzioni etj. të cilët kanë përgatitjen profesionale, të cilët janë shtetas të Malit të Zi dhe të cilët vendbanimin e kanë në Ulqin.

Kandidatët për emërimin e anëtarëve të Këshillit të RTUL i propozojnë subjektet me seli në Ulqin dhe atë:

1. Institucionet publike nga fusha e kulturës, një anëtar;
2. Institucionet arsimore, një anëtar;
3. Klubet sportive dhe shërbimet publike nga fusha e sportit, një anëtar;
4. Organizatat joqeveritare nga fusha e mediave, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtat e personave me invaliditet, një anëtar dhe
5. Shoqatat e biznesit dhe sipërmarrësit, një anëtar.

Personi që është propozuar për anëtar të Këshillit nuk është e domosdoshme të jetë nga radhët e propozuesit të autorizuar. Propozuesit nga paragrafi 1, pika 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni munden bashkë apo veç e veç të propozojnë kandidatin për anëtar të Këshillit. Kandidatët për anëtarë të Këshillit i propozojnë organet kompetente të administrimit të personave juridikë nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me statutet e tyre.

Anëtarë të Këshillit nuk mund të jenë:

1. deputetët dhe këshilltarët;
2. të punësuarit në RTUL;
3. personat të cilët i zgjedh ose i emëron Kryetari i Malit të Zi, Kuvendi i Malit të Zi ose Qeveria;
4. personat e zgjedhur apo emëruar në organet e vetëqeverisjes lokale; funksionarët e

partive politike (kryetarët e partive, anëtarët e kryesisë, zëvendësit e tyre, anëtarët e këshillave ekzekutues dhe kryesor, anëtarët e këshillave komunale dhe këshillave ekzekutive komunale si dhe funksionarët e tjerë partiakë).

5. personat të cilët si pronarë të hises, aksionarë, anëtarët e organeve udhëheqëse, anëtarët e organeve mbikëqyrëse, të punësuarit etj. kanë interes në personin juridik, të cilët merrem me prodhimin e programeve radiotelevizive, ashtu që anëtarësia në Këshill do të mund të çojë deri tek konflikti i interesit;
6. personat e dënuar për veprën penale abuzim me detyrën zyrtare, korrupsion, mashtrim, hajni apo vepra të tjera penale, që i bëjnë të padenjë për kryerjen e funksionit publik, pa marrë parasysh sanksionin e shqiptuar, ose janë dënuar për ndonjë vepër tjetër penale në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, në periudhën deri sa pasojat e vendimit vazhdojnë;
7. personat që janë bashkëshortë të personave të përmendur në pikën 1 deri 6 të këtij neni, ose me ta janë farefis në vijën e parë, pa marrë parasysh shkallën e farefisnisë, në linjën anësore deri tek shkalla e dytë e farefisnisë dhe shkalla e dytë e farefisnisë nga vjehri.
8. Nëse anëtari i Këshillit ka konflikt të interesit në lidhje me vendimmarrjen për çështje nga kompetencat e Këshillit, është i obliguar që për këtë të njoftojë anëtarët e tjerë të Këshillit me qëllim të përjashtimit nga diskutimi dhe vendimmarrja për atë çështje.
9. Nëse anëtari i Këshillit ka marrë pjesë në punë me ekzistencën e konfliktit të interesit, anëtarët e tjerë të Këshillit janë të obliguar që ta rishikojnë nxjerrjen e vendimit të nxjerrë të cilin mund ta shpallin të pavlefshëm.
10. Anëtari i Këshillit nuk mund të jetë themelues i ofruesit MAV shërbimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër merr pjesë si parashtrues i kërkesës për marrjen e lejes për ofrimin e MAV shërbimeve në afat prej 12 muajsh nga pushimi i mandatit.

Organizatat joqeveritare si propozues

Organizatat joqeveritare mund të jenë propozues për emërimin e anëtarit të Këshillit, nëse i plotësojnë këto kushte:

1. që tek organi i administratës shtetërore është i regjistruar së paku tri vite para shpalljes së thirrjes publike për paraqitjen e propozimit për emërimin e Këshillit;
2. që në aktin e themelimit dhe statute, si objektiva themelore dhe detyra të veprimtarisë, çështje nga fusha të cilat janë të parapara, si nga fusha e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtat e personave me invaliditet të këtij vendimi dhe që në tri vitet paraprake në vazhdimësi merren me fushat – veprimtaritë e përmendura.
3. Organizata e njëjtë joqeveritare mund të marrë pjesë në propozimin e kandidatit për anëtar të Këshillit vetëm në kuadër të një kategorie të propozuesve.
4. Organizatat joqeveritare dhe klubet sportive me rastin e propozimit të anëtarëve të Këshillit, janë të detyruar të dorëzojnë Statutin, Aktvendimin e regjistrimit lëshuar nga organi kompetent i administratës shtetërore, raportet e punës dhe raportet financiare nga tri vitet paraprake.

Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit përmban:

1. emrin dhe mbiemrin, adresën dhe një biografi të shkurtër të kandidatit të propozuar që

duhet të jetë i firmosur dhe i vërtetuar nga ana e propozuesit të autorizuar, përkatësisht propozuesve të autorizuar.

2. Propozimi i kandidatit për anëtar i Këshillit parashtrohet në formularin të cilin e përcakton Këshilli për zgjedhje dhe emërimet e Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Me propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen:

1. dëshmia që kandidati i propozuar është shtetas i Malit të zi dhe se vendbanimin e ka në Ulqin;
2. dëshminë për përgatitjen profesionale të kandidatit të propozuar;
3. deklarata e kandidatit të propozuar që e pranon kandidimin dhe se nuk ka pengesa nga neni 26 i këtij vendimi për emërimin e tij për anëtar të Këshillit.

Afati për paraqitjen e propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit rrjedh nga dita e publikimit të thirrjes publike nga neni 30 i këtij vendimi dhe zgjatën 30 ditë nga dita e publikimit. Këshilli për zgjedhje dhe emërimet e Kuvendit është i obliguar që në afat prej 8 ditësh nga dita e skadimit për propozimin e anëtarëve të Këshillit, të publikojë listën e propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit. Këshilli për zgjedhje dhe emërimet e Kuvendit është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e skadimit të afatit për propozimin e anëtarëve të Këshillit, të konfirmojë propozimin e listës për emërimin e Këshillit.

Propozimet për emërim dorëzohen në zarfa të mbyllur në byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit, me shenjën “Propozimi për anëtar të Këshillit të RTUL”. Nëse propozuesit propozojnë kandidatin e njëjtë, propozimin e përbashkët mund ta dorëzojnë në një zarf të mbyllur. Konkursi do të publikohet në servis publik dhe së paku dy gazeta ditore dhe në sajtin zyrtar të Komunës së Ulqinit <http://opstinaulcinj.com>

KRYETARI

Loro Nrekiq